



Biografi e shkurtër

Odise Xhelita, Këshilltar Ligjor

Është diplomuar me titullin “Jurist” në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2003 dhe në vitin 2004 ka fituar titullin “Avokat”, anëtar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë së Shqipërisë, Dhoma Tiranë. Në vitin 2006 është pranuar në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit Shtetëror dhe Kapodistrian të Athinës, ku është diplomuar me titullin Jurist, dhe më pas, në vitin 2008 ka fituar titullin Avokat, anëtar i Dhomës së Avokatisë Athinë.

Në vitin 2017 është diplomuar me titullin “Master në të Drejtën Publike” në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës. Nga viti 2008 deri në vitin 2009 ka ushtruar profesionin e Avokatit pranë “Drakopoulos Law Firm”, për t’u emëruar në vitin 2010 në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Hartimit dhe Përafrimit të Legjislacionit pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Prej vitit 2011 deri në vitin 2017 ka ushtruar profesionin e Avokatit pranë “Rokas International Law Firm”, për t’u emëruar në vitin 2018 në pozicionin e Këshilltarit Ligjor pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe atë greke.